

ÇOHU!

Organizata për  
Demokraci, Antikorrupsion  
dhe Dinjitet, Çohu!



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo



# E MUNDSHMJA E PAMUNDSHME

Deklarimi i Pasurisë dhe Konflikti i Interesit nga  
Perspektiva e Realitetit Ekzistues në Kosovë





# E MUNDSHMJA E PAMUNDSHME

Deklarimi i Pasurisë dhe Konflikti i Interesit nga  
Perspektiva e Realitetit Ekzistues në Kosovë

Ky publikim është mundësuar me mbështetje të KFOS- Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



**Deklaratë mohimi:**

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Organizatës Çohu!, dhe rrjedhimisht nuk reflekton qëndrimet e donatorëve të projektit.

**Autorë:**

Arton Demhasaj, Leonida Molliqaj  
dhe Qëndrim Bunjaku

**Lekturoi:**

Besa Kalaja

Originali është shkruar në shqip

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (SCO) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizatës Çohu! dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

**Publikuar nga:**

Organizata për Demokraci,  
Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!  
Rruga: UÇK 25-1; Prishtinë, Kosovë  
Tel / +381 (0)38 248 506  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

# PËRMBAJTJA

6

Përmbledhje  
Ekzekutive

8

Metodologjia

## PJESA E PARË

10

KAPITULLI I.

Praktika e  
Deklarimit

13

KAPITULLI II.

Kategoritë e  
Problemeve  
Themelore të  
Deklarimit të  
Pasurisë në  
Kosovë

## PJESA E DYTË

24

KAPITULLI III.

Konflikti i  
Interesit

30

Përfundime dhe  
Rekomandime  
Analitike



---

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Institucionet në formën se si me të drejtë do të duhej t'i mendojmë sot, në parim janë produkt i shoqërisë bashkëkohore, të cilat mandatohen për të kryer ato punë të specializuara që shoqëria si tërësi nuk ka mundësi t'i kryej. Rrjedhimisht, si të mandatuara, ato duhet të përpiqen të reflektojnë natyrën e mirëfilltë të përgjegjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Republika e Kosovës si një shtet i ri dhe në ndërtim e sipër, ka ngritur institucione konform rendit kushtetues dhe nevojave socio-politike, nga të cilat qytetarët marrin dhe presin shërbime publike. Megjithatë, në rrugëtimin e tyre drejt konsolidimit, institucionet në përgjithësi, përfshirë edhe këto të Kosovës, kalojnë në një trajektore dinamike dhe të vazhdueshme në përpjekje për të kryer mandatin e tyre e që shpesh herë hasin edhe në pengesa të natyrave të ndryshme.

Për faktin se institucionet ekzistojnë, çështja e parë që vjen në interes është shkalla e efektivitetit të tyre. Sa efikase janë të njëjtat, sa transparente dhe llogaridhënëse janë dhe sa i përgjigjen mandatin për të cilin ekzistojnë?

Në shoqëritë tranzitore shpesh herë ka qenë e vështirë që institucionet të kenë pavarësi të plotë për të ushtruar mandatin ligjor. Kjo situatë sjell pasoja që ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e besimit të qytetarëve në to. Për më tepër, në rastin kur institucionet nuk arrijnë të kryejnë obligimet e veta në mënyrë të pavarur si pasojë e ndikimit politik, ato ka gjasë që të asociohen me dukuri antidemokratike, siç është korrupsioni dhe praktikat e ndryshme të përdorimit të tyre për nevoja individuale dhe grupore.

## Për faktin se institucionet ekzistojnë, çështja e parë që vjen në interes është shkalla e efektivitetit të tyre. Sa efikase janë të njëjtat, sa transparente dhe llogaridhënëse janë dhe sa i përgjigjen mandatit për të cilin ekzistojnë?

Kjo analizë ka për qëllim të adresojë këtë problematikë, e parë ngusht vetëm në një drejtim, në atë të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë në Republikën e Kosovës dhe në sistemin ekzistues të parandalimit të pasurimit të paligjshëm. Konkretisht, analiza do të trajtojë çështjen e deklarimit të pasurisë në pjesën e parë dhe çështjen e konfliktit të interesit në pjesën e dytë.

Shembujt dhe logjika e trajtimit të problematikës së deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit të pasqyruar në këtë analizë janë ndërtuar përmes tri aspekteve themelore:

- a** Hermeneutikës, semantikës dhe impaktit social<sup>1</sup> të legjislacionit aktual që rregullon fushën e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit në Republikën e Kosovës;
- b** Metodologjisë, mandatit dhe përmbajtjes së punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit<sup>2</sup> përkritazi me çështjen se çfarë/cilat instrumente i përdorë ky institucion për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të deklaruara (pasurisë), dhe për të interpretuar të njëjtat në funksion të sundimit të ligjit; dhe
- c** Të dhënave empirike të Çohu! që pasqyrojnë segmente të realitetit ekzistues në këtë agjendë;

Megjithëse ka pasur përpjekje të vazhdueshme si nga ana e vetë akterëve institucionalë ashtu edhe nga akterët e jashtëm dhe shoqëria civile për të ngritur probleme kudo ku ato janë shfaqur, përpjekje këto që në raste kanë marrë vëmendjen e duhur e në raste tjera janë refuzuar si formë e shprehjes së mos respektit ndaj punës dhe vepërimitarisë së shoqërisë civile, ky punim në vazhdim është i ndërtuar me një gjuhë për të orientuar debatin andej ku do të duhej të zinte vend. Emrat e përveçëm që mund të hasen janë para së gjithash referencë e argumentimit të problemeve që paraqesin regjistrat e pasurisë dhe jo caqe individuale, sepse fokusi ynë edhe në të kaluarën si edhe sot, është luftimi i fenomeneve që lidhen me deficitet institucionale e jo domosdoshmërisht me emra të përveçëm.

Rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet që reflektohen në këtë analizë, nuk kanë qëllim primar të shërbejnë si instrument matës dhe kritikues i punës apo mos punës së akterëve të përfshirë në agjendën e luftimit të korrupsionit, por që të kontribuojnë në shtrimin e shumë segmenteve që janë bërë dhe vazhdojnë të jenë shkas për perceptimin e krijuar të prezencës së korrupsionit politik në Kosovë.

<sup>1</sup> Në terma të thjeshtë, leximi i legjislacionit, interpretimi i të kuptuarit të tij dhe ndikimi që ka i njëjti në bërjen funksional të sistemit të deklarimit të pasurisë;

<sup>2</sup> Më tutje në tekst: Agjencia, AKK;

---

# METODOLOGJIA

Hartimi i kësaj analize është bërë brenda Nivelit të Mesëm të Analizave, duke pasur në fokus shqyrtimin e rasteve individuale në njërin anë dhe shqyrtimin e politikave rregulluese dhe legjislativë në anën tjetër. Qasja për të ndërtuar një model vlerësimi mbi nivelin e implementimit të politikave kundër-korrupsionit në Kosovë dhe për të matur efektet e tyre është udhëhequr përmes perspektivës **interpretuese**.

Kjo qasje ka rrjedhur duke analizuar legjislacionin aktual dhe praktikën e implementimit përmes një modeli të kombinuar **kualitativ-kuantitativ**, ndërsa analizat janë bërë përmes logjikës së **deduksionit** përmes orientimit në fusha problematike dhe raste specifike që demonstrojnë këtë.

Për pjesën e parë, atë të deklaramit të pasurisë, është përzgjedhur një listë prej 71 zyrtarësh të lartë publikë të cilët kanë ushtruar apo vazhdojnë të ushtrojnë funksione publike nga viti 2010 e deri sot. Është me rëndësi të theksohet se për konsideratë janë marrë individë me ndikim të madh në sferën institucionale dhe publike, në rang kryetarë partishë, deputetë të disa legjislativave me radhë, drejtorë prokurimi në dikasterët qeveritar që kanë pasur buxhet më të lartë, drejtorë ekzekutiv në kompanitë publike dhe kryetarë komunash. Kriteri themelor për përfshirjen në hulumtim ka qenë që këta individë të klasifikimeve të mësipërme, të kenë qenë të paraparë për të deklaruar pasurinë në së paku tri vite. Për pjesën e dytë, atë të konfliktit të interesit, janë shqyrtuar disa raste të konfliktit të interesit të shqyrtuara nga AKK-ja dhe është bërë një interpretim analitik i legjislacionit dhe draft-ligjit të ri për parandalimin e konfliktit të interesit, përcjellë me rekomandimet tona.

Në kuptimin e burimeve themelore të shfrytëzuara për të hartuar kornizat logjike të argumenteve të shtrua, janë konsultuar në mes tjerash:

- a** Legjislacioni primar dhe sekondar i fushës së anti-korrupsionit në Kosovë;
- b** Raportet statistikore dhe dokumentet tjera relevante të përpunuara nga Agjencia Kundër Korrupsionit;
- c** Të dhënat empirike të hulumtuara dhe përpunuara nga Çohul;
- d** Intervistat e drejtpërdrejta me akterë të caktuar.



**PJESA  
E PARË**

**1**



# 3. PRAKTIKA E DEKLARIMIT TË PASURISË

Edhe pas plot nëntë vitesh të shtetësisë dhe veprimtarisë së institucioneve demokratike të Kosovës, në opinionin publik vazhdon të ekzistojë një përshtypje se korrupsioni e veçmas ai politik, i njohur si “Korrupsioni i Jakave të Bardha” është prezent dhe paraqet një nga problemet më të mëdha të vendit.<sup>3</sup> I njëjti është duke shkaktuar devijim të perspektivës së Kosovës drejt një shteti të sundimit të rendit dhe ligjit, në vetë mirëqenien e shoqërisë si dhe në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.

Pavarësisht se baza ligjore që ka për qëllim tejkalimin e këtij fenomeni dhe sanksionimin e veprave penale të korrupsionit, konfliktit të interesit, patronazhit politik dhe dukurive të tjera vartëse ekziston, çështja themelore lidhet me shkallën se sa i njëjti është i zbatueshëm. Për më tepër, debati mund të shtrohet edhe mbi vetë natyrën e bazës ligjore, nëse e njëjta u përgjigjet rrethanave socio-politike dhe socio-kulturore në mënyrë që të japë efekte reale për probleme të theksuara siç është në këtë rast korrupsioni.

Kjo analizë pretendon të japë një përfytyrim të realitetit ekzistues në këtë drejtim, porë në njërin nga dimensionet e luftës kundër korrupsionit. Duke u nisur nga premisa se përgjigja më e saktë për çështjen e ngritur më lartë mund të merret duke analizuar fushëveprimin e mekanizmave institucional që kanë përgjegjësi për zbatimin e këtyre ligjeve, rrjedhimisht, me fokus të veçantë kësaj radhe është

analizuar procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, përmes shqyrtimit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke qenë se AKK-ja është e thirrur për të zbatuar Ligjin për Deklarimin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik si dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Një vëmendje e madhe i është kushtuar edhe natyrës edukative të sistemit të deklarimit të pasurisë për të matur shkallën e integritetit të tij dhe për të vlerësuar nëse i njëjti ka instaluar brenda sistemit institucional, logjikën e transparencës dhe llogaridhënies së zyrtarëve të lartë publikë.

Në çdo përpjekje për të luftuar korrupsionin dhe veçmas atë që lidhet me politikën, pashmangshëm duhet adresuar praktikën e implementimit të ligjeve dhe analizuar rezultatet, kusht ky për mendimin tonë esencial, në mënyrë që të kuptohet jo vetëm trendi i rënie-ngritjes por edhe vetë natyra e korrupsionit. Me theks të veçantë, edhe në hulumtimet e mëhershme por edhe me këtë rast, të dhënat tona sugjerojnë një nevojë imediate për të riformuluar dhe bërë të njohur metodologjinë e punës së AKK-së, pasi që paqartësitë mbi rolin dhe mandatin e saj dhe instrumenteve që ajo ka në dispozicion për të verifikuar pasurinë apo për të mbikëqyrur të njëjtën kanë çuar në dështim të shumë rasteve gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe rrjedhimisht kanë ulur rendimentin e luftimit të korrupsionit, veçmas atë të “Jakave të Bardha”.

Pika kryesore që shtjellohet këtu është e ndarë në dy rrafshë:

<sup>3</sup> Transparency International “People and Corruption: Europe and Central Asia” Global Corruption Barometer, 2006; [https://www.transparency.org/whatwedo/publication/people\\_and\\_corruption\\_europe\\_and\\_central\\_asia\\_2016](https://www.transparency.org/whatwedo/publication/people_and_corruption_europe_and_central_asia_2016);

**1) Së pari, kemi një vështrim analitik dhe empirik të regjistrave të deklarimit të pasurisë dhe 2) Së dyti, kemi një vështrim kritik mbi pasaktësinë e të dhënave të deklaruara mbi pasurinë/asetet e zyrtarëve të lartë publikë;**

## 3.1 Praktika e Deklarimit

Procesi i deklarimit të pasurisë në Kosovë ka filluar nga viti 2007, paralelisht me kohën kur në rrafshin ndërkombëtar po vendoseshin bazat e forta në instrumentet kundër korrupsionit, të prira nga Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit<sup>4</sup> si dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Në fillim ky proces, edhe pse i rregulluar me Ligjin Kundër Korrupsionit, kishte kryesisht karakter administrativ. Baza ligjore ka ndryshuar disa herë përgjatë këtyre 10 viteve duke integruar përgjegjësi të reja dhe seç herë e më objektive. Me theks të veçantë vlen të përmendet hyrja në fuqi e Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) në vitin 2013, i cili në nenin 437 ka paraparë si vepër penale mos deklarimin apo deklarimin e rrejshëm të pasurisë,<sup>5</sup> duke e forcuar pozicionin e procesit të deklarimit. Aktualisht, procesi i deklarimit të pasurisë sipas bazës ligjore ekzistuese ka shënuar progres në kuptim të deklarimit në shifra (mos deklaruesit e pasurisë nga viti 2013 përgjithësisht janë numër i vogël) por ende vazhdon të ketë probleme në kuptim të përmbajtjes së asaj çka deklarohet dhe si deklarohet. Në terma teknik, zyrtarët e lartë publikë të paraparë me ligj për të deklaruar pasurinë e tyre, e bëjnë këtë me rastin e marrjes së detyrës, largimit nga detyra si dhe në bazë të rregulltë vjetore me datat 1 deri me 31 mars të vitit kalendarik. AKK-ja shqyrton formularët e pasurisë (kontrolli paraprak i pasurive) dhe pas një periudhe prej 60 ditësh, përkatësisht në muajin qershor të vitit kalendarik publikon regjistrat e pasurisë së zyrtarëve. Në pikëpamjen administrative dhe kohore, përgjithësisht është rritur serioziteti ndaj procesit të deklarimit, veçmas pas klasifikimit të mos deklarimit apo deklarimit të rrejshëm si vepër penale. Megjithatë, në pikëpamjen përmbajtësore, ku edhe do

të duhej të orientohej fokusi i procesit, ka një mori problemesh që janë përsëritur që nga fillimi dhe vazhdojnë të reflektohen edhe sot.

Praktika e deritanishme, për nga aspekti i përmbajtjes kryesisht sjell dy fusha të problemeve themelore që hasen në këtë proces:

- **Së pari**, problemet që lidhen me një mungesë të theksuar të harmonizimit të regjistrave të deklarimit të pasurisë që në përgjithësi pamundëson analizën mbi gjendjen reale të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, siç do të argumentohet me shembuj konkret në kapitullin vijues dhe;

- **Së dyti**, problemet që lidhen me mos-saktësimin dhe mungesën e konsistencës së vlerave të pasurisë së paluajtshme, asaj të luajtshme dhe asetëve të tjera qoftë si para të gatshme apo aksione të mbajtura në biznese private ndër vite, kredive dhe posaçërisht zbritjes akumulative të tyre, të cilat në parim pamundësojnë një analizë të mirëfilltë aritmetike mbi relacionin e pasurive të deklaruara me të hyrat e zyrtarëve të lartë publikë.

Trendët e problemeve praktike të deklarimit prej se i njëjti ka filluar të aplikohet e deri me tani tregojnë thellime të mëdha në substancën e procesit. Në listën e kategorive të problemeve substanciale për t'u konsideruar kane qenë dhe mbetën ende, të tillat si në vijim:<sup>6</sup>

- Vlefshmëria e të dhënave të deklaruara dhe veçmas atyre të publikuara në regjistrat e AKK-së;
- Mungesa e standardeve të vlerave të pasurisë së paluajtshme dhe asaj të luajtshme dhe narracionet e mangëta në kuptim të sqarimit dhe arsyetimit të tyre;
- Paqartësitë rreth origjinës dhe prejardhjes së pasurisë;
- Mos deklarimi i pasurive jashtë vendit, ose pamundësia e verifikimit të pasurive jashtë vendit etj.

4 United Nations Office on Drugs and Crime, UNODC (2004); United Nations Convention Against Corruption: [http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026\\_E.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf)

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2012): Kodi Penal i Republikës së Kosovës: Neni 437 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>

6 Për më tepër rreth natyrës së defekteve të sistemit, shih edhe analizën **"Kriza e Depërtimit: Procesi i Deklarimit të Pasurisë- Kontrolli dhe vërtetësia e të dhënave"** Altin Ademi, Arton Demhasaj, Lorik Bajrami, COHU! Shkurt, 2015; <http://www.cohu.org/sq/zyre-qeverisje-qeverisja-e-mire-hulumtime/Deklarimi-i-Pasurise-Kontrolli-dhe-Vertetesia-e-te-Dhenave-173>;

Paraqitja e problemeve materiale me regjistra, qoftë për shkak të mosplotësimit të duhur apo të pjesshëm të regjistrave apo mbushjes së formularëve nga persona vartës të zyrtarëve të lartë publikë, fshehja me apo pa dashje e të dhënave mbi pronësinë e bizneseve, posedimit të aksioneve apo të ardhurave nga to, mbi prejardhjen e pasurisë dhe mbi pronësinë e pronave të patundshme, si dhe paqartësitë mbi obligimet ndaj debive dhe kredive të zyrtarëve të lartë publikë nëpër bankat e Kosovës dhe në mes palëve të tjera, janë indikatorë që janë hasur nga të gjeturat tona dhe reflektojnë një të kuptuar se një verifikim dhe vlerësim i paanshëm nga jashtë, përkatësisht nga shoqëria civile, por edhe vetë AKK-ja, është pothuajse i pamundur.

Ky trend i mangësive të shumta ndër vite ka reduktuar në masë të madhe kredibilitetin e sistemit të deklarimit të pasurisë dhe tërthorazi edhe vetë mandatin e AKK-së.

Atë çfarë praktika e deritanishme e deklarimit të pasurisë ndër vite e ka sjellë në vëmendje, mund të përmblihdhen në shpjegimin e katër shtyllave bosht të krizës së konsolidimit të procesit të deklarimit në tërësi.

**Së pari**, janë problemet e natyrës teknike administrative që lidhen me vetë aktin e mbushjes së formularëve nga ana e zyrtarëve, për t'u përcjellë me bartjen e të dhënave nga formulari në regjistra nga ana e AKK-së dhe që në këtë vijë paraqesin një gamë të gjërë defektesh procedurale. Si një institucion përgjegjës, AKK-ja shpesh herë nuk e ka marrë mundin për të sqaruar me zyrtarët përkatës devijimet e thella që mund të hasën në formularë dhe i ka publikuar të njëjtat në regjistrat publikë, duke krijuar paqartësi të mëdha për lexuesit dhe komentuesit e jashtëm. Këto defekte në shikim të parë edhe pse procedurale, paraqesin shkelje potenciale të Ligjit për Deklarim të Pasurisë, por një pjesë e madhe e tyre nuk janë trajtuar si të tilla nga AKK-ja;

**Së dyti**, janë problemet e natyrës përmbajtësore, që paraqesin një mori defektesh në mënyrën e konstatimit të veprës penale për mos deklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë. Këto defekte lidhen në radhë të parë me metodologjinë e punës së AKK-së dhe me formën se si ajo i konstaton shkeljet përkatëse.

**Së treti**, janë problemet e natyrës mandatuese, apo ato që lidhen me aspektet se deri ku shtrihet mandati i AKK-së për të realizuar në mënyrë të mirëfilltë procesin e deklarimit të pasurisë dhe për të siguruar transparencë të plotë. Në këtë rrafsh, mungesa e kompetencave të drejtpërdrejta dhe pafuqia për të realizuar kompetencat që tashmë i ka në dispozicion kanë ndikuar që AKK-ja të mos shërbejë si një institucion në të cilin qytetarët shohin vendin ku duhet raportuar apo luftuar korrupsioni;

**Së katërti**, janë problemet e natyrës ligjore, që paraqesin aspektet e paqartësisë së zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe dënimeve sipas KPRK-së për veprën e paraparë për mos deklarim dhe deklarim të rrejshëm, me theks të veçantë në aspektin e interpretimit të masave ndëshkuese.

Përgjithësisht, punimi më tutje do të flasë për gjetje reale të gabimeve dhe të metave materiale të procesit të deklarimit, të cilat në konkluzion mund të përmblihdhen me një pyetje themelore që është shtruar në substancë të kësaj analize: ***A janë regjistrat e deklarimit të pasurisë të publikuar në ueb faqen e AKK-së dokumente zyrtare të cilat mund të merren si bazë juridike nga aktet e jashtëm që mbikëqyrin pasurinë e zyrtarëve të lartë publikë, dhe sa të sakta janë të dhënat e pasqyruara në to?***

## KAPITULLI II

# 4. KATEGORITË E PROBLEMEVE THEMELORE TË DEKLARIMIT TË PASURISË NË KOSOVË – TË GJETURAT KRYESORE

Me rastin e publikimit të regjistrave të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik në qershor të vitit 2017, u përfol shumë për rastin e prokurores Merita Lumezi, e cila doli të jetë një nga prokuroret më të pasura jo vetëm në Kosovë por mbase në përmasa globale,<sup>7</sup> me një shumë të parave të mbajtura në bankë në vlerë prej 67 milionë eurosh. Pas publikimit të këtij detaji, prokurorja Lumezi u bë subjekt i lajmeve dhe debateve të shumta, megjithëse në fund figuroi që e tëra ishte një gabim i AKK-së në plotësimin e regjistrave ku në vend të shënimit të shumës prej 668,857.00 euro<sup>8</sup> AKK-ja kishte shënuar shumën prej 66,885,724.00 euro. Ky rast, është vetëm njëri në mesin e shumë rasteve të tjera të përditshme dhe të përvitshme që AKK-ja i pasqyron në mënyrë të gabuar, duke dhënë përshtypje shpesh herë të paqëndrueshme rreth pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Të metat në paraqitjen e të dhënave në regjistrat publik kanë qenë pikënisja për të ndërmarë këtë hulumtim analitik, për shkak se paraqit-

ja jo e saktë e të dhënave nuk ka asnjë shpjegim tjetër përveçse në tri rrafshje:

- a** Ose zyrtarët e lartë publikë të obliguar për të deklaruar pasurinë, nuk janë duke e bërë mirëfilli këtë obligim ligjor me shkas për të fshehur pasurinë e tyre të cilën mund ta kenë krijuar në mënyrë të paligjshme;
- b** Ose zyrtarët ligjor gabojnë me rastin e paraqitjes së të dhënave të tyre dhe AKK-ja nuk merret me verifikimin e saktësisë së të dhënave, përveçse kur media ose shoqëria civile ngre për debat të gjeturat e kësaj natyre siç ishte rasti me prokuroren Lumezi;
- c** Ose AKK-ja vërtetë ka shumë mangësi në ushtrimin e funksionit të saj dhe paqartësi në mandatin e saj, si nga aspekti i mungesës së kuadrove profesionale që janë të thirrur për të vërejtur këto mangësi, ashtu edhe në aspektin e ushtrimit të kompetencave ligjore të cilat mund edhe të mos jenë të mjaftueshme;

7 <http://infokusi.com/kush-eshte-prokurorja-e-kosoves-qe-ka-67-milione-euro-ne-banke-dokument/>

8 Shih deklarin e përmirësuar: [http://www.akk-ks.org/declaration/2017/Institucionet\\_e\\_Pavarura/Keshilli\\_Prokurorial\\_i\\_Kosoves-Prokuroret/Merita\\_Lumezi.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2017/Institucionet_e_Pavarura/Keshilli_Prokurorial_i_Kosoves-Prokuroret/Merita_Lumezi.pdf);

Me qëllim që të dalin në pah argumentet që hedhin poshtë ndonjërin nga mundësitë e lartpërmendura dhe të forcojnë argumentet për njërin nga mundësitë në mesin e këtyre të lartpërmendura, ky hulumtim është ndërtuar si një masë e vlerësimit nga jashtë të regjistrave të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve, për të parë nëse ajo çka paraqitet në regjistra është brenda kornizës ligjore dhe nëse ka probleme, në adresë të kujt duhet dërguar të njëjtat.

Mostrat e trajtuara të zyrtarëve të lartë publikë për këtë analizë janë përzgjedhur mbi kriterin e mbajtjes së posteve publike të rëndësishme në së paku tri vite, përkatësisht në periudhën 2010-2016. Rrjedhimisht, janë shqyrtuar regjistrat e pasurisë për 71 zyrtarë të lartë publikë të paraparë për deklarim dhe janë krahasuar të dhënat ndër vite për të parë mënyrën se si është deklaruar pasuria e tyre.

Në këtë rrafsh, më tutje janë dhënë të gjeturat kryesore nga rastet e studimit, të cilat flasin për problemet me procesin e vërtetësisë së të dhënave të deklaruar, paqartësisë së tyre dhe pamundësisë për t'u shfrytëzuar nga akterë të jashtëm:

Problemet e gjetura në regjistrat e pasurisë janë klasifikuar në probleme që lidhen me pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme, të hyrat, paratë e gatshme si dhe paraqitja e bizneseve apo aksioneve. Në këtë aspekt, pas një analize të detajshme të regjistrave të pasurisë të publikuara në faqen e AKK-së, dhe një interpretimi të ligjit mbi të cilin organizohet dhe vepron ky proces, kemi identifikuar gjithsej këto kategori problemesh:

- 01 Mos deklarim i prejardhjes së pasurisë;
- 02 Krijimi i pasurive të reja pa shpjeguar qartë prejardhjen;
- 03 Mos deklarim i vlerës së pasurisë apo deklarim i vlerës ndryshe ndër vite;
- 04 Mos deklarim konstant i sipërfaqes së pasurive të paluajtshme;
- 05 Mos deklarim të vitit të përfitimit të pasurisë;

- 06 Paqartësitë në pronësi;
- 07 Problemet me deklarimin e pasurive të përfituara gjatë periudhës 1999-2010;
- 08 Mos deklarimi i pasurive të paluajtshme në vite të ndryshme;
- 09 In-konsistenca me deklarimin e prejardhjes së pasurisë;
- 10 In-konsistenca me deklarimin e vitit të përfitimit të pasurisë;
- 11 Dallimet e vlerësimit të pasurisë ndër vite;
- 12 Mos deklarimi i pasurisë së luajtshme ndër vite të ndryshme;
- 13 Paqartësitë e deklarimit të të hyrave;
- 14 Mos deklarimi i të hyrave;
- 15 Deklarimi i të hyrave pa deklaruar burimin e tyre;
- 16 Shpërputhjet në mes të të hyrave dhe parave të gatshme;
- 17 Deklarimi i njëjtë i parave të gatshme për disa vite me radhë;
- 18 Mbajtja e aksioneve në kundërshtim me ligjin;
- 19 Mosdeklarimi i aksioneve;

Vlen të theksohet se këto probleme janë të pranishme në shumicën e regjistrave. E veçanta e kësaj liste të kategorive të problemeve merr rëndësi për faktin se të gjitha nga problemet e hasura në regjistra paraqesin shkelje të ligjit dhe rrjedhimisht janë edhe vepër penale në bazë të nenit 437 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Po ashtu duhet theksuar se këto probleme të identifikuara, pavarësisht faktit se për nga emërtimi asociojnë të jenë të ngjashme, në esencë të gjitha janë probleme të ndryshme dhe unike në kontekstin e bazës ligjore.

Të gjitha këto probleme e bëjnë thuajse të pamundur arrijtjen e qëllimit kryesor të procesit të deklarimit, që është identifikimi potencial i krijimit të pasurive të jashtëligjshme gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Për të argumentuar më tutje këto të gjetura, më poshtë janë dhënë disa të dhëna specifike që lidhen me secilën nga kategoritë e problemeve të hasura gjatë implementimit.

## 4.1 Problemet me deklarimin e pasurive të paluajtshme

Ndër problemet më të theksuara në tërë procesin e deklarimit të pasurisë, janë ato që lidhen me pasurinë e paluajtshme. Për faktin se në sensin e luftës kundër korrupsionit, pasuria e paluajtshme paraqet një nga segmentet më vulnerable nga ku do të duhej të kërkohet llogaridhënia nëse përfitimet e zyrtarëve të lartë publikë në kuptim të shtimit të pasurive të paluajtshme, kanë origjinë të pastër apo diskutabile, pikërisht këtu vërehet nëse sistemi i deklarimit është i ndërtuar asisoj që të mund të evidentojë çdo pasuri të përfituar jashtëligjshëm. Të dhënat e hulumtimit tregojnë qartë se ky sistem, në drejtim të pasurive të paluajtshme ka deficite të mëdha që pothuajse e bëjnë tërësisht jo relevant procesin e deklarimit.

Në kuptimin e gjërë, të gjeturat tona flasin për fenomene duke u nisur prej paqartësive mbi origjinën e pasurisë së paluajtshme e deri te problemet me kompromiset që bën AKK-ja me rastet kur p.sh. një zyrtar deklaroi shitjen e një prone në vlerë të caktuar dhe blerjen e një prone tjetër në emër të shitjes së pronës së mëparshme, por që prona e re tejkalon dyfish vlerën e pronës së shitur, duke mos arsyetuar kështu kushtimisht, se si ka mundësi që me paratë e shitjes së një prone, të blejë një pronë dyfish më të shtrenjtë e që flet për shpërputhje totale të vlerave të pasurisë.

Në kuptimin e termave teknik, problemet me pasurinë e paluajtshme që janë vërejtur, janë paraqitur në pikat në vijim:

01

### MOS DEKLARIM I PREJARDHJES SË PASURISË:

Problemi i mos deklarimit të prejardhjes së pasurisë, ndonëse i specifikuar në mënyrë të qartë si imperativ me Ligjin për Deklarim dhe si vepër penale me Kodin Penal të Kosovës, sërish mund të evidentohet në regjistrat e pasurisë. Nga gjithsej 71 rastet e studimit, ne kemi gjetur shkelje të kësaj natyre në **tri** raste.<sup>9</sup> Në parim, një evidencim i tillë do të duhej të ishte pjesë e kontrollit nga ana e AKK-së, e cila do të duhej të kërkonte sqarimet e nevojshme nga zyrtarët përkatës dhe rrjedhimisht t'i trajtojë këto raste në procedurë të mëtejshme;

02

### KRIJIMI I PASURIVE TË REJA NUK ËSHTË I ARSYETUAR QARTË:

Edhe ky segment paraqet një problem të gjërë që është hasur në **6 raste** nga gjithsej 71 të studiuar. Ky segment pasqyron mungesën e konsistencës në aspektin e deklarimit të pasurisë së përfituar ndër vite përmes mungesës së arsytimit apo arsytimit kompleks që e pamundësojnë çfarëdo sqarimi se nga rrjedh pasuria e shtuar. Shembull tipik për këtë është rasti i Sokol Bashotës i cili ka deklaruar një kredi në vitin 2012 për blerjen e një banese, në anën tjetër deri në vitin 2016 nuk ka deklaruar ndonjë banesë të re. Në vitin 2016 ka deklaruar edhe dy detyrime financiare të reja në vlerë 76,970 euro me qëllim të blerjes së banesës. Në total detyrimet e deklaruara me qëllim të blerjes së banesës janë në vlerë **91,970** euro, ndërsa banesa e deklaruar në vitin 2016 është deklaruar në vlerë **150,000** euro. Pra dallimi në mes të detyrimeve dhe vlerës së pasurisë së deklaruar është rreth 60 mijë euro.<sup>10</sup>

9 Për ilustrim, drejtori në Ministrinë e Shëndetësisë, z. Gani Shabani në deklarimin e vitit 2015, për tri njësi të paluajtshme, në regjistrat e pasurisë thotë se janë deklaruar në vitin 2008: [http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Queveria/Ministria\\_e\\_Shendetesise/Gani\\_Shabani.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Queveria/Ministria_e_Shendetesise/Gani_Shabani.pdf). Një situatë të ngjashme kemi edhe në regjistrat e Besim Beqaj dhe Duda Balje;

10 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve: Abelard Tahiri, Nexhat Demaku, Enver Hasani, Adem Grabovci dhe Hashim Thaçi.

03

### MOS DEKLARIM I VLERËS SË PASURISË APO DEKLARIM I VLERËS NDRYSHE NDËR VITE:

Po ashtu edhe kjo e metë në regjistrat e deklarimit të pasurisë është evidente në masë të gjerë. Mos deklarimi i vlerës së pasurisë nga ana e zyrtarëve e pamundëson matjen e pasurisë së tyre. Problem ende më i madh është deklarimi ndryshe i pasurisë ndër vite. Ka raste kur i njëjti zyrtar ka deklaruar të njëjtën pronë me vlera aspak të përafërta në vite të ndryshme gjë e cila realisht është e pamundur të ndodhë. Në hulumtimin tonë janë evidentuar plot **22 raste**<sup>11</sup> të kësaj natyre që qartazi flet për deficitin e procesit të deklarimit të pasurisë si masë në saktësinë e të dhënave të deklaruara.

04

### MOS DEKLARIM KONSTANT I SIPËRFAQES SË PASURIVE TË PALUAJTSHME:

Në mesin e problemeve që hasen shpesh dhe në masë të konsiderueshme edhe në këtë rast, gjithsej **7 raste**, është edhe problemi i mos deklarimit konstant ndër vite i sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme. Një rast tipik për demonstrim kësaj radhe e gjejmë tek deputeti Haxhi Shala, i cili një pronë e ka deklaruar herë në sipërfaqe prej 2 ha, e herë në sipërfaqe prej 10 ha.<sup>12</sup>

05

### MOS DEKLARIM I VITIT TË PËRFITIMIT TË PASURISË:

Një nga problemet më të theksuar në tërë procesin e deklarimit të pasurisë janë paqartësitë në deklarimin e vitit të përfitimit të pasurisë. Të gjeturat tona eja

11 Për ilustrim mund të merren rastet e zyrtarëve: Besim Beqaj, Skender Gashi, Adem Grabovci, Safete Hadërgjonaj, Vjosa Osmani, Rexhep Selimi, Fatmir Limaj, Haxhi Shala, Jakup Krasniqi, Shkëlzen Lluka, Adrian Zalli, Sylë Hoxha, Mujë Rugova, Rexhë Gjonbalaj, Avdullah Haxhiu, Bekim Jashari, Arben Gjukaj, Fejzullah Hasani, Abelard Tahiri, Xhemaj Buzuku, Xhavit Haliti, Behxhet Pacolli.

12 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve: Skender Gashi, Rexhep Selimi, Sylë Hoxha, Abelard Tahiri, Xhavit Haliti, Behxhet Pacolli

gjithsej **5 raste**<sup>13</sup> të problemeve të kësaj natyre. Në aspektin përmbajtjesor ky problem është tejet serioz sepse bie ndesh kryekëput me qëllimin e deklarimit të pasurisë në përgjithësi. Nën fshehjen e vitit të përfitimit të pasurisë mund të lindë dyshimi se pasuritë e tilla janë përfituar në kushte dhe rrethana të kundërligjshme. Këtë e komplikon edhe më tepër fakti se ligji ekzistues nuk ka asnjë bazë retroaktiviteti para vitit 2007 kur edhe ka hyrë në fuqi, duke ndikuar kështu në një lloj amnistie kohore që siguron përfituesit e mundshëm të pasurisë së paligjshme.

06

### PAQARTËSITË RRETH PRONËSISË:

Ndonëse në të gjeturat prej analizimit të 71 rasteve, figuron vetëm një **rast**<sup>14</sup> në të cilin ka paqartësi të plotë sa i përket pronësisë, prapë se prapë ky problem në procesin e deklarimit të pasurisë është serioz dhe do të duhej të trajtohej si i tillë nga ana e AKK-së. Për më tepër, paqartësia e pronësisë në atë që deklarohet është vetëm njëra anë e medaljes. Në realitet, shqetësimi i AKK-së do të duhet të orvatej në dyshimet jo pak të shpeshta për pronësinë de fakto të pasurive nga ana e zyrtarëve të lartë publikë megjithëse de jure e bartur apo nën administrimin e palëve të treta. Nëse ky fenomen që teknikisht është i mundshëm, të bëhej rutinë e përdorimit, atëherë është një agjens më shumë në sigurimin e parajsës së pasurimit të paligjshëm të zyrtarëve të lartë publikë, ndaj të cilëve, AKK-ja nuk ka asnjë mekanizëm për t'i kontrolluar;

07

### PROBLEMATIKA E MOSKONTROLLIT TË PASURIVE TË KRIJUARA GJATË VITEVE 1999-2010:

Ka shumë zyrtarë të cilët kanë ushtruar funksione publike edhe gjatë periudhës 1999-2010 dhe për të cilët është e pamundur të kontrollohet se si i kanë përfituar pasuritë. Nga kjo perspektivë, deklarimi i pasurisë nuk ka mandat për të shqyrtuar pasurinë e themeluar para vitit 2007 kur

13 Zyrtarët të cilët nuk e kanë deklaruar vitin e përfitimit të pasurisë janë: Besim Beqaj, Ardian Gjini, Fatmir Limaj, Rexhë Gjonbalaj, Duda Balje,

14 Shih regjistrat e zyrtarit Skender Gashi ndër vite;



edhe ka hyrë në fuqi ligji. Në mungesë masash të retroaktivitetit, çdo zyrtar eventualisht ka mundur të përfitojë pasuri ndër vite për të cilat nuk ndihet llogaridhënës. Kjo perspektivë e mungesës së transparencës tregon për mendësinë “ortodokse” të interpretimit të rolit dhe funksionit të deklarimit të pasurisë, dhe si e tillë nuk mund të sjellë rezultate efektive në luftën kundër korrupsionit dhe veçmas atij të bartur në nivelet e larta politike e institucionale. Edhe pse procesi i deklarimit të pasurisë ka filluar në vitin 2007, regjistrat e deklarimit për herë të parë janë publikuar në vitin 2010, gjë që e pamundëson kontrollin nga jashtë për periudhën 2007-2010.

08

#### **MOS DEKLARIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME NË VITE TË NDRYSHME:**

Tek kjo kategori problemesh, janë paraqitur gjithsej **23 raste**. Ky problem lidhet kryesisht me aspektin e paqartësisë që krijohet në interpretimin e pasurisë së deklaruar. Konkretisht, paqartësitë lidhen me deklarimin e një prone në një vit, pastaj mos deklarimin e saj në vitet tjera dhe sërish deklarimin e saj në vitet pasuese. Një rast tipik i kësaj natyre mund të gjendet tek deklarimi i zyrtarit Arben Gjokaj i cili një banesë të cilën e deklaruar se e ka përfituar në vitin 2012, për herë të parë e ka deklaruar në vitin 2015.<sup>15</sup>

Këto probleme të lartpërmendura që lidhen me pasuritë e paluajtshme, siç mund të shihet, flasin për dështimin e procesit të deklarimit për nga perspektiva përmbajtjesore. Me këto paqartësi në regjistra, çdo prokuror apo vëzhgues i jashtëm do ta kishte tepër të vështirë të iniciojë një padi të argumentuar për shkak se lajthitja profesionale është evidente si pasojë e paqartësive të mëdha që i karakterizojnë regjistrat publik të pasurisë së zyrtarëve, për të cilat përgjegjësia në radhë të parë i takon edhe AKK-së, që nuk kontrollon me kohë dhe nuk kërkon sqarime nga zyrtarët me rastin e dorëzimit të formularëve.

## 4.2 Problemet me Deklarimin e Pasurisë së Luajtshme

Lista e mëposhtme lidhet me problemet e deklarimit të pasurisë së luajtshme, të cilat po ashtu paraqesin shembuj të shumtë të devijimeve në raport me konstatimet e sakta të gjendjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

01

#### **MOS DEKLARIMI I PASURISË SË LUAJTSHME NDRË VITE TË NDRYSHME:**

Nga të gjeturat e hulumtimit, figuron që në **19 raste** të ndryshme të zyrtarëve,<sup>16</sup> nuk ka pasur deklarim të pasurisë së luajtshme ndër vite të ndryshme. Kjo praktikë e dëmshme, e shkëputë lidhjen logjike të shtimit apo zvogëlimit të pasurisë përmes paqartësisë se çfarë ndodhë rëndom me pasurinë e luajtshme e cila deklarohet me një rast, ndërsa nuk deklarohet në vitet tjera, për t’u ri deklaruar sërish, pa dhënë asnjë lloj arsyetimi.

02

#### **IN-KONSISTENCA ME DEKLARIMIN E PREJARDHJES SË PASURISË:**

Rastet e tilla të deklarimit që nuk japin asnjë të dhënë mbi prejardhjen e pasurisë e që konsiderohet si tejet e rëndësishme në tërë kredibilitetin e procesit vazhdojnë të reflektohen edhe sot e kësaj dite në këtë drejtim. Vetëm në analizimin e 71 rasteve janë gjetur **4 raste** të tilla. Për referencë, deputetja e Kuvendit të Kosovës Duda Balje dhe deputeti Pal Lekaj në deklarimin e pasurisë nuk kanë dhënë asnjë shpjegim për prejardhjen e pasurisë së paluajtshme të tyre.<sup>17</sup>

15 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve: Lutfi Haziri, Ahmet Shala, Shukri Buja, Vjosa Osmani, Visar Ymeri, Glauk Konjufca, Rexhep Selimi, Ardian Gjini, Haxhi Shala, Bedri Hamza, Safet Hoxha, Hysni Hoxha, Adrian Zalli, Sali Mekaj, Mujë Rugova, Rexhë Gjonbalaj, Bekim Jashari, Fejzullah Hasani, Hajredin Kuqi, Abelard Tahiri, Xhavit Dakaj, Xhavit Halli

16 Zyrtarët të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë e luajtshme në vitet e ndryshme janë: Lutfi Haziri, Skender Gashi, Arben Gashi, Glauk Konjufca, Rexhep Selimi, Fatmit Limaj, Jakup Krasniqi, Ferid Agani, Valdete Daka, Safet Hoxha, Mentor Shala, Ekrem Hoxha, Sali Mekaj, Agron Mustafa, Duda Balje, Blerand Stavileci, Enver Hoxhaj, Xhavit Dakaj, Xhemajl Buzuku ;

17 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve Haxhi Shala dhe Agron Thaçi

**03****IN-KONSISTENCA ME DEKLARIMIN E VITIT TË PËRFITIMIT TË PASURISË:**

Përveç mos deklarimit të prejardhjes së pasurisë, problemi tjetër i përafërt që është hasur në këtë hulumtim është edhe in-konsistenca me deklarimin e vitit të përfitimit të pasurisë. Gjithsej janë gjetur 8 raste me problemin e tillë. Shembull lidhur me këtë problem mund të jetë zyrtari Salih Mekaj, ish gjyqtar, i cili pasuritë e luajtshme thujse asnjëherë nuk i ka deklaruar me vlera të njëjta si dhe në paraqitjen e tyre ka ndërruar vitin e përfitimit. Në vitin 2015 ka deklaruar për herë të parë një veturë me vit të përfitimit 2011. Poashtu në 2015 nuk ka deklaruar asnjë nga pasuritë paraprake të luajtshme, disa nga të cilat në 2016 prapë janë deklaruar.<sup>18</sup>

**04****MOS DEKLARIMI DHE DEKLARIMI NDRYSHE NDËR VITE I VLERËS SË PASURISË:**

Edhe problemi i deklarimit të pasurisë së luajtshme me vlerë të ndryshme ndër vite apo mos deklarimi fare i saj është hasur në 6 raste.<sup>19</sup> Mos deklarimi apo dallimet e vlerës së pasurisë ndër vite janë thelbi që deshifron tërë logjikën e mosfunksionimit të sistemit të deklarimit. Loja me shifra të vlerës së pasurisë ku zyrtarët në një rast i vlerësojnë asetet lartë e në rastin tjetër i ulin dyfish vlerat e këtyre aseteve tregon se indikator i matjes së pasurisë reale të tyre është ekskluzivisht shprehje e vullnetit personal të zyrtarëve më shumë sesa masë për të përcaktuar se çfarë vlerë të pasurisë posedojnë, e për çfarë AKK-ja nuk ka ndërmarrë asgjë në asnjë rrethanë kur kjo është hapur e shprehur.

**05****KRIJIMI I PASURIVE TË REJA NUK ËSHTË I ARSYETUAR QARTË:**

Njëjtë sikurse te pasuritë e paluajtshme edhe te ato të luajtshme të reja hasim probleme me arsyetimin e tyre. Gjithsej kemi identifikuar 6 raste<sup>20</sup> të tilla ku zyrtarët nuk e kanë deklaruar qartë krijimin e pasurive të reja të luajtshme. Si ilustrim mund të merret rasti i zyrtarit Pal Lekaj i cili gjatë viteve 2013-2016, ka deklaruar se ka blerë tetë vetura në vlerë 158,000 euro, ndërsa të hyrat e deklaruara për këtë periudhë kohore janë 18,900 euro. Vlera e pasurive të përfituara është 139,100 euro më e madhe sesa të hyrat e deklaruara. Poashtu deklarimi i pasurisë së luajtshme nuk është bërë për njësi veç e veç, por disa nga njësitë janë deklaruar si një dhe me vlerë totale.

## 4.3 Problemet me Deklarimin e të Hyrave, Parave të Gatshme dhe Aksioneve në Shoqëri Aksionare

**01****PAQARTËSITË E DEKLARIMIT TË TË HYRAVE:**

Një problem i theksuar dhe i shprehur në 11 raste të ndryshme të zyrtarëve të lartë publikë nga të gjeturat tona, është edhe ky i paqartësive në deklarimin e të hyrave. Konkretisht, ky problem lidhet me mungesën e të dhënave themelore mbi llojin e të hyrave, për shkak të deklarimit të pozitive ndaras dhe të hyrave në total, pastaj për shkak të deklarimit të të hyrave pa deklaruar

18 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve: Lutfi Haziri, Pal Lekaj, Haxhi Shala, Bedri Hamza, Agron Thaçi, Bekim Jashari, Duda Balje

19 Shih regjistrat e zyrtarëve të cilët kanë këto mangësi: Lutfi Haziri, Haxhi Shala, Jakup Krasniqi, Sali Mekaj, Abdullah Haxhiu, Bekim Jashari

20 Shih regjistrat e zyrtarëve të cilët kanë këto mangësi: Safete Hadërgjonaj, Donika Kadaj, Fatmir Limaj, Valdete Daka, Agron Thaçi

burimin etj. Nga 11 rastet e gjetura në hulumtimin tonë, për referencë ja vlen të konsiderohet rasti i Fejzullah Hasanit, i cili të hyrat e tij i deklaroi në total, por pa sqaruar ndaras edhe burimet se nga ku arkëtohen të hyrat.<sup>21</sup> Duhet sqaruar se në një intervistë me realizuesit e hulumtimit, z. Hasani e ka bërë të qartë se mbanë vetëm një llogari bankare dhe rrjedhimisht të gjitha të hyrat e tij kanë shkuar përmes të njëjtës, gjë që në periudha të caktuara e ka pasur të vështirë të klasifikojë burimet dhe shumat ndaras për secilin aktivitet profesional. Me gjithë faktin se i njëjti pa qëllim ka deklaruar vetëm shumën totale të të hyrave në bazë vjetore, AKK-ja nuk ka sqaruar me zyrтарin nevojën për të pasqyruar saktë burimet dhe të hyrat ndaras, në mënyrë që të mund të përfitohet një kalkulim i saktë i trendit të të hyrave të zyrтарit në fjalë, që është edhe qëllimi themelor i vetë deklarimit.

Poashtu një problem tjetër që është identifikuar është edhe deklarimi i të hyrave por jo burimi i tyre dhe deklarimi i burimit por jo vlera e të hyrave.<sup>22</sup>

02

### MOS DEKLARIMI I TË HYRAVE:

Përveç paqartësisë së deklarimit të të hyrave, hulumtimi ka gjetur **6 raste** ku të hyrat nuk janë deklaruar fare. Zyrтарi Mujë Rugova, në vitin 2010 nuk ka deklaruar fare të hyrat e tij.<sup>23</sup>

03

### SHPËRPTHJET NË MES TË TË HYRAVE DHE PARAVE TË GATSHME:

Nga problemet që mund të shërbejnë si referencë për komentim të shumanshëm të procesit të deklarimit të pasurisë në kuptim të efikasitetit të parandalimit të pasur-

imit të paligjshëm të zyrtarëve të lartë publikë, është edhe problemi i shpërputhjes në mes të të hyrave dhe parave të gatshme të mbajtura në llogari bankare. Nga hulumtimi ynë kemi hasur gjithsej **9 raste**<sup>24</sup> me karakteristikat e tilla, të cilat në formën se si janë deklaruar në mënyrë logjike nuk mund të klasifikohen ndryshe përveçse si gabime të paqëllimshme, ose si fshehje direkte e të hyrave të paarsyetuara. Përderisa Formularët e Deklarimit të AKK-së janë dokumente zyrtare, na bën të kuptojmë se zyrtarët e lartë publikë në rastet e shumta nuk janë të kujdesshëm për plotësimin e formularëve të deklarimit të pasurisë dhe këtë punë zakonisht ua lënë vartësve të tyre, gjë që paraqet problem shumë serioz dhe mungesë respekti institucional ndaj procesit si tërësi. Për të sqaruar këtë aspekt, më tutje po japim shkurtimisht disa shembuj:

**a Rasti i Kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri.** Haziri në vitin 2013 ka deklaruar të hyra vjetore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht nga paga si deputet, në shumë prej 96,000.00 eurosh.<sup>25</sup> Kjo i bien përkatësisht nga 8,000.00 euro në muaj, ndonëse ligjërisht është e ditur se sa është paga bazë e një deputeti, i cili në rastin më të mirë përfshirë të gjitha mëditjet dhe kompensimet tjera për punë neper komisione, nga puna në Kuvendin e Kosovës nuk mund të tejkalojë shumën prej 20-25 mijë eurosh. Megjithatë përderisa në regjistrin e AKK-së ky deklarim është publik, kjo nënkupton sërish ose për një gabim njerëzor apo teknik të bërë pa qëllim ose për një deklarim të pavërtetë që do të mund të ishte bazë për ngritje padie nga një palë e tretë. Me gjithë tentativën dhe konfirmimin e Hazirit për një takim relevant për të shpjeguar të gjeturat në fjalë, në realitet një takim i tillë nuk ka ndodhur si pasojë e agjendave të ngjeshura të zyrтарit në fjalë. Rrjedhimisht, edhe sot ende nuk e kemi të qartë se cila është situata reale me një formë të tillë të deklarimit.

21 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve: Lutfi Haziri, Skender Gashi, Shukri Buja, Adem Grabovci, Safete Hadërgjonaj, Agron Mustafa, Blerand Stavileci, Gani Shabani, Xhavit Dakaj, Xhemajl Buzuku

22 Shih regjistrat e zyrtarëve të cilët kanë këto mangësi: Agron Thaçi, Fejzullah Hasani, Hajredin Kuçi

23 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve: Hysni Hoxha, Fejzullah Hasani, Blerand Stavileci, Xhavit Haliti, Behxhet Pacolli

24 Raste tjera të ngjashme paraqiten edhe në regjistrat e zyrtarëve: Besim Beqaj, Sabri Hamiti, Mujë Rugova, Enver Hoxhaj, Nexhat Krasniqi, Ramadan Muja, Behxhet Pacolli

25 Shih regjistrin e z. Haziri: [http://www.akk-ks.org/declaration/2013/Kuvendi/Lutfi\\_Haziri.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2013/Kuvendi/Lutfi_Haziri.pdf).

**b** **Regjistrat e ish ministrit të Punëve të Jashtme, z. Hoxhaj.** Në regjistrin e vitit 2014, z. Hoxhaj deklaroi para të gatshme të mbajtura në bankë në vlerën prej 11 mijë eurosh.<sup>26</sup> Në vitin 2015, i njëjti deklaroi para të gatshme të mbajtura në bankë në vlerën prej 92, 440.00 eurosh.<sup>27</sup> Diferenca mes vitit 2014-2015 është për 81,063.00 euro më shumë, ndërsa të hyrat totale të tij dhe familjarëve të tij brenda atij viti nuk kalojnë shifrën prej 30,000.00 eurosh. Ministri Hoxhaj ka thënë për Çohu! se në vitin 2014 ka deklaruar vetëm diferencën nga viti 2013 e cila nuk është pasqyruar qartë në regjistrin e publikuar nga AKK-ja. Si rrjedhojë diferenca nga viti 2014 në vitin 2015 (ku pastaj është deklaruar vlera totale e parave të gatshme) është rritur për rreth 81 mijë euro. Rrjedhimisht, AKK-ja me kësi lëshimesh ka shkaktuar devijim të pasqyrimin të realitetit ekzistues dhe e bënë të pamundur kontrollin e rritjes së pasurisë së zyrtarëve përmes regjistrave publik.

**c** **Rasti i regjistrave të ish- presidentes Jahjaga.** Se regjistrat e AKK-së kanë gabime dhe nuk pasqyrojnë realitetin e gjendjes në njërin anë, dhe se zyrtarët publikë përgjithësisht janë mospërfillës ndaj procesit të deklarimit të pasurisë në anën tjetër e demonstroi edhe rasti i ish- presidentes Jahjaga. Jahjaga në vitin 2012 deklaroi para të gatshme të mbajtura në bankë në shumën prej 778 eurosh dhe ato të deklaruara si të bashkëshortit të saj, ndërsa vetë nuk deklaroi asnjë para të gatshme.<sup>28</sup> Në vitin pasues, 2013, Jahjaga deklaroi para të gatshme të mbajtura në bankë në shumën prej 47 mijë eurosh.<sup>29</sup> Nga deklaratimet e burimeve të të hyrave kuptohet se ajo dhe bashkëshorti i saj brenda vitit 2012 kanë realizuar të hyra në shumën prej 34,478 eurosh. Rrjedhimisht, paratë e gatshme të deklaruara në vitin 2013 nuk gjejnë arsyetim. Megjithatë gjatë takimit me Jahjagën e njëjta ka sqaruar se paratë e mbajtura në bankë nga ajo në vitin 2012 nuk janë deklaruar për

shkak të gabimit teknik të bërë nga asistentët e saj, dhe ka arritur të arsyetojë prejardhjen e kësaj shume, prapë se prapë AKK-ja nuk ka kërkuar sqarime nga zyrtarja për deklarimin e tillë.

***Këto raste janë indikacion i rëndësishëm se si regjistrat e AKK-së edhe pse janë dokumente zyrtare, mund të vënë në lajthitje çdo palë të tretë që kërkon t'i marrë të njëjtit për referencë.***

04

#### **DEKLARIMI I NJËJTË I PARAVE TË GATSHME PËR DISA VITE ME RADHË:**

Në mesin e të gjeturave tona kemi edhe rastin e deputetit Albin Kurti,<sup>30</sup> i cili në çdo periudhë të deklarimit të pasurisë paraqet bilancin 0 (zero) të parave të mbajtura në banka, pavarësisht faktit se i njëjti merr pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës për punën e deputetit në Kuvendin e Kosovës. Në rrethana të zakonshme kjo nuk paraqet ndonjë problem praktik, por në aspektin e funksionimit të mekanizmit të deklarimit të pasurisë, paraqitja e parave të gatshme në vlerën e njëjtë, në këtë rast 0 euro e në raste të tjera shuma fikse ndër vite, shtuar faktit se shuma e njëjtë ndër vite e parave të mbajtura në një institucion bankar nuk mund të jetë përherë e njëjtë, se paku do të ulej për mirëmbajtjen e llogarisë, paraqet edhe një segment të mungesës së seriozitetit të procesit në mënyrën se si është rregulluar i njëjti.

05

#### **MBAJTJA E AKSIONEVE NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN:**

Në lidhje me problemin tejet serioz të posedimit të aksioneve në mënyrë të kundërligjshme, hulumtimi sjell dy raste në të cilat është evidentuar ky problem. Ish kryem-

26 Shih regjistrin 2014: [http://www.akk-ks.org/declaration/2014/Qeveria/Ministria\\_e\\_Puneve\\_te\\_Jashtme/Enver\\_Hoxhaj.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2014/Qeveria/Ministria_e_Puneve_te_Jashtme/Enver_Hoxhaj.pdf);

27 Shih regjistrin 2015: [http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Enver\\_Hoxhaj.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Enver_Hoxhaj.pdf)

28 Shih regjistrin e vitit 2012: [http://www.akk-ks.org/declaration/2012/Presidenca/Atifete\\_Jahjaga.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2012/Presidenca/Atifete_Jahjaga.pdf);

29 Shih regjistrin e vitit 2013: [http://www.akk-ks.org/declaration/2013/Presidenca/Atifete\\_Jahjaga.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2013/Presidenca/Atifete_Jahjaga.pdf)

30 Shih regjistrat ndër vite të z. Kurti: [http://www.akk-ks.org/declaration/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Albin\\_Kurti.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Albin_Kurti.pdf); [http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Albin\\_Kurti.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Albin_Kurti.pdf); [http://www.akk-ks.org/declaration/2016/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Albin\\_Kurti.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2016/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Albin_Kurti.pdf);

inistri i Kosovës, Isa Mustafa në vitin 2015 dhe 2016 ka deklaruar posedimin e 16% të aksioneve në Riinvest,<sup>31</sup> gjë që bie ndesh me Ligjin për Konfliktin e Interesit. Rasti tjetër është ai i ish deputetit dhe kryetarit të Komunës së Lipjanit, Shukri Buja, i cili në vitin 2016 ndonëse në rolin e deputetit, deklaroi aksione në dy biznese, njëri në vlerën 80 % ndërsa tjetri në vlerën 100%.<sup>32</sup>

06

## MOS DEKLARIM I AKSIONEVE:

Problemi akoma më i madh paraqitet në rastin e mos deklarimit të aksioneve. Në këtë hulumtim janë gjetur gjithsej **12 raste**<sup>33</sup> ku zyrtarët e lartë publik nuk kanë deklaruar aksionet e mbajtura neper biznese të ndryshme. Për referencë, shih rastin e ish ministrit Stavileci. Ish ministri Blerand Stavileci në vitin 2014 deklaroi 6.66 % aksione në një kompani, ndërsa në vitin 2015 nuk deklaroi aksionet në biznesin në fjalë. Në një intervistë të realizuar nga ekipi hulumtues, i njëjti ka sqaruar se biznesi në fjalë është shuar dhe se administruesi i tij ka pasur për obligim të bëjë mbylljen formale të biznesit, megjithatë përderisa i njëjti ende është në listën e ARBK-së, do të duhej të deklarohet.<sup>34</sup>

Në aspektin statistikor, nga 71 rastet e shqyrtuara, vetëm tek regjistrat e **11 zyrtarëve** nuk është gjetur asnjë mospërputhje ndërsa **60 zyrtarë** kanë mospërputhje në së paku njëri nga kategoritë e deklarimit e deri tek 4 zyrtarë që kanë nga 6 mospërputhje gjithsej. Kjo statistikë e të metave të regjistrave nuk mund të argumentohet ndryshe përveçse flet qartë se sistemi i deklarimit të pasurisë në Kosovë është para së gjithash një sistem procedural administrativ dhe fiktiv për nga natyra. Për më tepër, edhe pse s'është treguar i fuqishëm për të investiguar apo sjellë në pah argumente të korrupsionit dhe pasurimit të paligjshëm të zyrtarëve për nga aspekti përmbajtësor, siç u pa në rastet e mësipërme, i njëjti ka plot gabime edhe në rrafshin administrativ. Mbi këtë bazë, është kri-

juar një përshtypje se ajo çka reflekton puna e AAK-së në raport me procesin e deklarimit nuk është asgjë tjetër përveçse një pasqyrë deri diku e saktë e asaj çfarë zyrtarët e lartë publikë kanë vullnet për të prezantuar. Në një pyetje drejtuar Drejtorit të AKK-së Havolli nga ana e Komisionit Parlamentar për Legjislacionin, nëse regjistrat e pasurisë të publikuara në faqen elektronike të AKK-së janë dokumente zyrtare dhe të vlefshme juridikisht për të ngritur padi duke u bazuar në to, i njëjti kishte deklaruar se regjistrat janë dokumente zyrtare dhe juridikisht të vlefshme për të adresuar shkeljet eventuale. Nëse e marrim për bazë këtë deklaratë dhe të gjeturat e hulumtimit tonë, AKK-ja ose do të duhej të ngriste padi për të gjithë zyrtarët tek të cilët janë evidentuar gabimet e trajtuara më lartë ose do të duhej të konsultohet me të njëjtin paraqishtë për të evituar këto gabime. Deri më tani, asnjëri nga këta hapa nuk është ndërmarrë.

Kjo logjikë e zhvlerëson edhe më tej procesin e deklarimit të pasurisë duke e bërë atë jo relevant saqë vetë mandati i AKK-së si një mekanizëm për të luftuar korrupsionin në nivelin e institucioneve publike dhe veçmas atë që lidhet me “jakët e bardha” vjen në pikëpyetje.

Sado që të përpiqemi për të kuptuar rrethanat dhe vështirësitë socio-politike që karakterizojnë shtet-ndërtimin e Kosovës, prapë se prapë fuqizimi i pikëpamjes fataliste mbi qeverisjen si diçka që nuk korrespondon me kërkesat e qytetarëve për drejtësi dhe barazi para ligjit, është dominante kur dalin në pah të gjetura të kësaj natyre. Natyrisht, nuk ka asnjë tendencë për të përlulur funksionin dhe rolin e AKK-së si mekanizëm për parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, por logjika që rrjedh nga të gjeturat detyrimisht se na nxitë për të kërkuar një ndryshim substancial në raport me AKK-në, në mënyrë që e njëjta të përmbushë mirëfilli rolin dhe mandatin e saj dhe të kalojë në stadin e një institucioni ligjor të respektuar që prodhon efekte sociale, të integritetit publik dhe domethënëse në agjendën kundër dukurive negative brenda sferës institucionale.

31 Shih regjistrat 2015, 2016: [http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Isa\\_Mustafa.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Isa_Mustafa.pdf); [http://www.akk-ks.org/declaration/2016/Qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Isa\\_Mustafa.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2016/Qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Isa_Mustafa.pdf);

32 Shih regjistrin e vitit 2016: [http://www.akk-ks.org/declaration/2016/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Shukri\\_Buja.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2016/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Shukri_Buja.pdf);


33 Shih regjistrat e zyrtarëve të cilët kanë këto mangësi: Isa Mustafa, Skender Gashi, Veton Firzi, Pal Lekaj, Shukri Buja, Donika Kadaj, Ukë Rugova, Ferid Agani, Ejup Qerimi, Blerand Stavileci, Gani Shabani, Xhavit Haliti

34 Shih dhe krahaso regjistrat 2014-2015: [http://www.akk-ks.org/declaration/2014/Qeveria/Ministria\\_e\\_Bujqesise\\_Pylltarise\\_dhe\\_Zhvillimit\\_Rural/BlerandStavileci.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2014/Qeveria/Ministria_e_Bujqesise_Pylltarise_dhe_Zhvillimit_Rural/BlerandStavileci.pdf); [http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Qeveria/Ministria\\_e\\_Zhvillimit\\_Ekonomik/Blerand\\_Stavileci.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Qeveria/Ministria_e_Zhvillimit_Ekonomik/Blerand_Stavileci.pdf);



**PJESA  
E DYTË**

2



## KAPITULLI III

# KONFLIKTI I INTERESIT

Konflikti i Interesit është temë brenda kornizës së temave që kanë për qëllim luftimin dhe parandalimin e dukurive antiligjore dhe antidemokratike në sferën institucionale. Si i tillë, rregullimi i shmangies së konfliktit të interesit përbën një nga tre shtyllat themelore në fushën kundër korrupsionit, paralelisht me Deklarimin e Pasurisë dhe Konfiskimin e Pasurisë. Meqenëse konflikti i interesit edhe nga perspektiva globale është shtruar në agjendën legjislative relativisht vonë, në terma krahasues ka larmani sistemesh dhe rregullimesh duke filluar nga definimi se çfarë paraqet konflikti i interesit e deri te kodifikimi i parandalimit, dënimit dhe pasojave të ushtrimit të tij nga zyrtarët e lartë publik. Një pjesë e mirë e legjislacionit që rregullon këtë fushë, bazohet edhe në aspektet socio-kulturore përveç atyre normative edhe në formatin e institucioneve të atyre shteteve. Për një pjesë të vendeve, (Amerika Latine, Azia, Afrika) çështja e konfliktit të interesit deri vonë është konsideruar si çështje e etikës personale dhe nuk ka qenë e disiplinuar me norma ligjore.

Megjithëse nuk ka modele unike, në rrafshin ndërkom-bëtar përherë e më shumë vërehet përafrimi drejt standardeve unike. Vendet e zhvilluara në njëzetvjeçarim e fundit i kanë kushtuar rëndësi të konsiderueshme përmirësimit të këtij aspekti.

Megjithëse nuk mund të flasim për sisteme unike legjislative që rregullojnë çështjen e konfliktit të interesit, lirisht mund të flasim për parimet që kanë udhëhequr ndërtimin e këtyre sistemeve si dhe trendet kryesore në fushën e konfliktit të interesit në 20 vitet e fundit. Në këtë bazë, këto parime dhe trende të hartimit të legjislacionit mbi konfliktin e interesit, përgjithësisht përfshijnë:

- a Tendencën për përkufizimet e qarta të konfliktit të interesit, si një domosdoshmëri juridike që mundëson përkthimin e masave ligjore në masa konkrete parandaluese dhe në sqarimin e situatave konkrete se kur një zyrtar është në konflikt të interesit;
- b Nxitjen e një kodi të ri të sjelljes, duke rritur standardet e integritetit dhe përgjegjshmërisë së zyrtarëve të lartë publikë në vetë rregullimin e mos rënies në konflikt të interesit para se një organ zbatues i legjislacionit të merrte masa;
- c Zgjerimin e shkallës së përfshirjes së zyrtarëve të lartë publik ndaj të cilëve zbatohet nocioni i konfliktit të interesit duke përfshirë edhe zyrtarët në organet administrative e jo vetëm ato politike;
- d Përforcimin e monitorimit dhe parandalimit, si tendencë për të evituar situatat e rënies në konflikt interesi;
- e Kampanja vetëdijesimi që kanë për qëllim sqarimin e situatave dhe rrethanave kur një zyrtar është potencialisht në konflikt interesi në njërën anë, si dhe vetëdijesimin e akterëve institucional dhe komunitetit të shoqërisë civile e qytetarëve për të evidentuar rastet e tilla dhe për t'i paraqitur të njëjtat me qëllim të parandalimit të shkaktimit të dëmit publik dhe ruajtjes së integritetit të institucioneve publike;



Nga praktika e deritanishme në hartimin e legjisllacionit, kanë dominuar disa modele dhe qasje të përgjithshme të kornizës ligjore, të cilat në kuptim të përgjithshëm përfshijnë parimet si vijon:

- a** Qasjet restriktive, të cilat rregullojnë, ndalojnë dhe kufizojnë një numër të madh çështjesh, kërkojnë dhe obligojnë zyrtarët që të deklarojnë pasuritë, marrëdhëniet dhe konfliktet e mundshme si dhe ruajnë të drejtën për të ushtruar një kontroll të plotë dhe një monitorim të plotë të konfliktit të mundshëm të interesit; Në këtë listë futen vendet si Koreja e Jugut, Polonia, Irlanda, Lituania, Italia, Kandaia, Franca etj;
- b** Qasjet e Moderuara, të cilat rregullojnë, ndalojnë dhe kufizojnë një numër çështjesh por lënë mundësinë për përjashtime të caktuara dhe kanë më pak mekanizma të kontrollit dhe monitorimit; në këtë listë janë SHBA-të, Gjermania, Suedia, etj.
- c** Qasjet e Buta, të cilat kryesisht bazohen mbi vullnetin e lirë të zyrtarëve për të parandaluar dhe shmangur konfliktin e interesit si dhe bazohen në një numër të rregulloreve të brendshme (vetë-rregullimeve) dhe vetë-sanksionimeve. Në këtë listë mund të referohen vendet si Brazili, Australia dhe Zelanda e Re të cilat kanë një numër të madh agjencishë publike ndaj zyrtarëve të cilave ka rregulla më liberale;

Përveç klasifikimit të qasjeve për nga forca sanksionuese e normave, në praktikën legjisllative të konfliktit të interesit ekzistojnë edhe modele strukturore mbi natyrën e legjisllacionit dhe parimeve që ai duhet të përmbajë, e të cilat kryesisht mund të klasifikohen në dy koncepte përfshirje:

- a** Qasja e përgjithshme, sipas së cilës legjisllacioni reflekton vetëm pjesët e përgjithshme të normave, parandalimeve, dhe sanksionimeve të konfliktit të interesit, praktikë kjo që zbatohet në SHBA, Gjermani, Itali, Finlandë, Suedi, etj.; si dhe
- b** Qasja preskriptive (përshkruese) sipas së cilës, legjisllacioni reflekton trajtimin e rasteve të veçanta të konfliktit të interesit duke definuar përmes ras-

teve atë së çka paraqet konflikti dhe si duhet parandaluar ai. Një pjesë e madhe e vendeve të BE-së, Kanadaja, Koreja e Jugut e kanë këtë qasje përshkruese në legjisllacionin e tyre.

Një karakteristikë tjetër e legjisllacionit që rregullon evitimin e konfliktit të interesit është edhe fakti se në disa legjisllacione të natyrës më të decentralizuar, ka elemente që përfshijnë jo vetëm aspektin publik, por edhe atë civil dhe komercial (Gjermania, Koreja e Jugut). Po ashtu për t'u marrë në konsideratë në aspektin krahasues, vlen edhe përmendja se disa legjisllacione siç është ai i Koresë së Jugut, konfliktin e interesit e sanksionojnë dhe e bëjnë të dënueshëm edhe kur nuk ekziston *"quid pro quo"*.<sup>35</sup>

Në disa legjisllacione, konflikti i interesit është paraparë të rregullohet edhe me legjisllacion sekondar dhe me rregullore të brendshme të institucioneve përkatëse. Megjithëse trendi është që çdo shtet të ketë një legjisllacion primar në lidhje me konfliktin e interesit.

## 5.1 Trajtimi i konfliktit të interesit në Kosovë apo iluzionet e luftës kundër korrupsionit

Agjencia Kundër Korrupsionit si mekanizëm zbatues i ligjit kundër konfliktit të interesit, në baza të shpeshta kohore lëshon opinione dhe rekomandime ndaj zyrtarëve që potencialisht mund të gjenden në konflikt të interesit, masa këto që ajo i publikon në ueb faqen zyrtare. Është me rëndësi të theksohet se për një mori rastësh, opinionet dhe rekomandimet përgjithësisht figurojnë të jenë të qëlluara ndërsa ka edhe raste të tilla që ngrejné dilema substanciale. E megjithë faktin se AKK-ja lëshon rekomandime parandaluese, korrupsioni dhe lidhjet mes interesave private me ato publike të zyrtarëve të lartë publikë, vazhdojnë të jenë temë e përditshmërisë.

<sup>35</sup> Parimi sipas së cilit një palë jep diçka në shkëmbim të pranimit të diçkaje tjetër. Në Korenë e Jugut, pavarësisht se një zyrtar publik nuk e zbaton në praktikë këtë parim, prapëseprapë ai konsiderohet se ka bërë shkelje në rast se ka lejuar apo nxitur në çfarëdo forme përfitim të një pale të dytë edhe pse vetë nuk ka përfitur asgjë.

Arsyet për këtë situatë të sundimit të formalitetit juridik e lulëzimit të informalitetit substancial në sferën institucionale të Kosovës janë të shumta, por këtu do trajtohet vetëm njëra- perspektiva ligjore që e rregullon këtë fushë.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Ligji), edhe pse si qëllim ka qartësimin e kësaj fushe si dhe krijimin e konditave për identifikimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit, prapëseprapë nuk po arrinë ta bëjë një gjë të tillë në praktikë. Kodifikimi juridik i konfliktit të interesit është njëra prej sferave më të ndërlikuara të luftës kundër korrupsionit. Kryesisht ky ndërlikim lidhet me faktin sa a përbën konflikt të interesit një vepër penale në vetvete apo konflikti i interesit është vetëm njëra prej rrugëve për gjenerimin e veprave tjera penale po që në vetvete nuk përbën vepër penale.

Rjedhimisht, një nga hapat e parë në drejtim të ridefinimit të nevojshëm legal është harmonizimi i ligjit ekzistues me Kodin Penal,<sup>36</sup> në mënyrë që konflikti i interesit të marrë karakter të veprës penale.

Nga perspektiva e Çohu!-t, konsiderojmë se **“ushtrimi i vazhdueshëm i konfliktit të interesit”** në vetvete përbën një vepër penale dhe si i tillë duhet të penalizohet me Kodin Penal të Kosovës. Në këtë kuptim, Ligji ka si të metë të tij themelore mos penalizimin e “ushtrimit të vazhdueshëm të konfliktit të interesit” pasi që si kategori juridike nuk është e përfshirë në Kodin Penal. Kështu, penalizimi jo i qartë i konfliktit të interesit ka bërë që një numër i zyrtarëve të lartë publikë të ushtrorjnë funksione që realisht përbëjnë konflikt interesi<sup>37</sup> dhe si të tilla do të duhet të ishin të dënueshme.

36 EU- Kosovo Stabilisation Association Process Dialogue (SAPD), Konklusions Ref. Ares (2014)393846-18/02/2014

37 ÇOHU! në fillim të viti 2008 ka bërë kallëzim penal ndaj kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi, pasi që ky kishte propozuar Dino Hasanaj si kryetar të Bordit të AKM-së. Vendimi i datës 25.03.08, me të cilin Qeveria propozon z. Dino Asanaj për anëtar bordi në AKM, përkundër asaj që i njëjti ishte aksionar në kompaninë IPKO. Asanaj është caktuar anëtar bordi me vendim të PSSP-së.

Vendimi i prokurorit ndërkombëtar datë 17.04.08, me të cilin e ka hedhur kallëzimin penal ushtruar nga ÇOHU! kundër Kryeministrit Hashim Thaçi, me arsyetimin se veprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale e cila ndiqet zyrtarisht, por duke pohuar që emërimi i z. Asanaj në bord të AKM-së është konflikt interesi sepse IPKO dhe PTK kanë nënshkruar një marrëveshje interkoneksioni ku interesi pronësor i z. Asanaj në IPKO mund të bie në konflikt me përgjegjësitë e tij në administrimin e PTK që është ndërmarrje publike dhe kjo paraqet shkelje të nënparagrafit (d) seksioni 12.5 të rregullores 2005/18 i cili thotë që “Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet drejtor nëse...d) ka interesa të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15”.

Po ashtu, Lëvizja FOL në maj ka publikuar një listë me 7 zyrtarë të lartë publikë të cilët kanë vazhduar t'i ushtrorjnë dy funksione të cilat janë në konflikt interesi me njëra- tjetrën. Shih Koha Ditore 12.05.2010.

Përveç kësaj, edhe kategoritë si: **“fshehje e konfliktit të interesit”**; **“mosdeklarimi /refuzimi i deklarimit të konfliktit të interesit”**; apo **“deklarimi i rrejshëm i konfliktit të interesit”**, nuk janë të përfshira në Kodin Penal dhe rrjedhimisht as në ligj. Si të tilla, mungesa e penalizimit të këtyre kategorive juridike, bënë që Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit mos të jetë efektiv në praktikë në parandalimin dhe luftimin e shfaqjes së konfliktit të interesit.

Është i nevojshëm edhe **klasifikimi i konfliktit të interesit karshi niveleve apo funksioneve të zyrtarit**, kjo për të shmangur edhe kolezionin e mundshëm të Ligjit për Parandalim të Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik me Kushtetutën e vendit dhe me ligje të tjera. Klasifikimi i konfliktit të interesit karshi funksioneve duhet të bëhet edhe në rrafshin e barasvlerësimit të zyrtarëve politikë me ata civil për shkak se ndasia ekzistuese që njëres palë i lejon angazhime politike ndërsa palës tjetër i ndalon të njëjtën reflekton një ambiguitet që komplikon funksionimin normal të këtij ligji. Për referencë, Ligji për Konflikt të Interesit shprehimisht thotë: *zyrtarët kanë të drejtë të ushtrorjnë poste në organet udhëheqëse të partive politike, ose të jenë në krye të partive politike krahas ushtrimit të funksionit publik*. Mirëpo kjo nuk mund të vlejë sidomos për presidentin e vendit, për arsye sepse bie në kundërshtim direkt me Kushtetutën. Kushtetuta ndalon ushtrimin e funksionit të udhëheqësit të partisë krahas me funksionin e presidentit të vendit (rasti Fatmir Sejdiu).

Nëse i referohemi rasteve të studimit të prezantuar më lartë dhe logjikës së si funksionon koncepti i konfliktit të interesit në legjisllacionin ekzistues të Kosovës, atëherë kjo korrespondon me një sistem pothuasje fiktiv, i cili është ortodoks për nga natyra dhe realisht jo dobiprurës. Për të reflektuar natyrën e interpretimit të ligjit ekzistues, më poshtë janë dhënë disa raste të shqyrtimit të Konfliktit të Interesit nga ana e AKK-së, vendime këto që sipas perspektivës tonë janë në kundërshtim me ligjin.

## 5.2 Vendimet e AKK-së për konflikt të interesit

Vendimet me të cilat AKK-ja vendosë për gjendjen e konfliktit të interesit në vetvete përmbajnë një sërë paqartësish dhe gabimesh, të cilat i bëjnë këto vendime që të mos jenë të njëjta varësisht prej zyrarit.

Në përgjithësi vendimet e AKK-së, për konflikt të interesit mund të kategorizohen në tri grupe:

- vendimet me të cilat vertetohet gjendja e konfliktit të interesit dhe lënda dërgohet në procedurë kundërva-jtëse në gjykatën kompetente;
- vendimet me të cilat mbyllet procedura e konfliktit të interesit, pas shmangies së konfliktit ose për mungesë provash, por që konflikti i interesit është në mes sferës publike dhe private;
- vendimet me të cilat mbyllet procedura e konfliktit të interesit, për mungesë provash, por që konflikti i interesit është në mes sferës publike dhe publike.

Ky kategorizim i vendimeve të AKK-së për nga natyra, asocohet edhe me një kategorizim të paqartësive substanciale të cilat sipas klasifikimit tonë figurojnë të jenë të njëjtat si vijon:

- **Së pari** në shumicën e vendimeve nuk kemi datën e fillimit të hetimit nga AKK-ja;
- **Së dyti** nuk kemi datën e thirrjes së zyrarit në Agjenci për të diskutuar lidhur me gjendjen e konfliktit të interesit dhe për ballafaqimin e fakteve në mes palëve;
- **Së treti** nuk kemi datë të caktuar se për sa kohë duhet që zyrari ta shmangë konfliktin e interesit, dhe
- **Së katërti**, ka paqartësi rreth afatit të dytë paralajmërues në disa vendime të disa zyrarë, të cilet nuk e respektojnë afatin e parë të AKK-së.

Në terma konkret, më poshtë janë dhënë disa raste specifike që në logjikën tonë përfshijnë kategoritë e paqartësive të sipërpermendura:

**a** **Rasti Abdyl Hasani** - AKK mbyllë rastin për prova të pamjaftueshme për të dëshmuar konfliktin e interesit. Hasani punon si kryesues i bordit të kompanisë regjionale Hidromorava dhe njëkohësisht punon në kompaninë private “Bejta Commerce”. Mundësia e konfliktit të interesit në këtë rast ekziston për arsye se Hasani mund të ndikojë në kompaninë regjionale Hidromorava që të jepen tenderë për kompaninë private Bejta Commerce, ku Hasani është i punësuar. Sido që të jetë në vendimin e AKK-së në këtë rastë **nuk përmendet fare se në bazë të cilit nen të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit**, rasti në fjalë hidhet poshtë për arsye të provave të pamjaftueshme, pra në këtë rast kemi një vendim pa u referuar fare në ligjin që e rregullon këtë fushë.

**RASTET E DY NJOFTIMEVE PARALAJMËRUESE** - në disa raste AKK-ja ju dërgon nga dy njoftime paralajmëruese zyrtarëve që gjinden në konflikt të interesit sipas AKK-së, me të cilët kërkon nga zyrarët që të shmangin gjendjen e konfliktit të interesit. Në këto raste Agjencia nuk referohet fare në ligj, me anë të cilit ekzistojnë ose jo këto afate, (rasti Milazim Shatri, Veton Nevzati, Gani Ibrahim, Agron Kryeziu etj.), në të gjitha keto raste Agjencia ka dërguar nga dy shkresa paralajmëruese për zyrarët, dhe atë pasi që nuk është respektuar afati i dhënë në shkresën e parë për shmangie të konfliktit i dërgohet edhe shkresa e dytë.

→ Ligji nuk njeht dërgimin e dy shkresave paralajmëruese, në nenin “18 procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit, paragrafi 7. *Nëse pas zgjedhjes, emërimit, ose konfirmimit të mandatit, personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej një aktivitet apo funksion që ky ligj e përcakton si të papajtueshëm me funksionin e ri, Agjencia e paralajmëron personin zyrtar të lartë dhe vendosë një afat sipas të cilit atij do t’i kërkohet të ndërpresë aktivitetin apo të heqë dorë nga posti.*” Kjo nënkupton shkresën paralajmëruese që Agjencia i dërgon zyrarit me anë të së cilës kërkon që të shmangë konfliktin e interesit, dhe në të cilën shkresë do të duhej të vendosej një afat i caktuar, brenda të cilit do të duhej të bëhej shmangia e konfliktit. Ky afat nuk është i caktuar me ligj, dhe kjo i mbetet Agjencisë ta vendosë, mirëpo kjo është një e metë e ligjit, sepse afati duhet të

percaktohet me ligj, dhe jo t'i lihet Agjencisë vendosja e afatit, për arsye të heqjes së mundësisë së keqperdorimit në varësi të zyrtarit. Kjo për arsye se për një zyrtar mund të lejohet një afat më i gjatë e për një tjetër një afat më i shkurtër.

→ Nëse nuk respektohet afati i dhënë nga Agjencia në shkresën paralajmëruese, duhet të fillohet procedura kundërvajtëse e paraparë me ligj. Sipas paragrafit 8 dhe 9 të nenit 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të fillojë procedurën për shkarkimin e tij. Organi kompetent ku personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej një aktivitet ose funksion të papajtueshëm me këtë ligj, duhet të fillojë procedurën për shkarkimin nga funksioni sipas kërkesës së Agjencisë.

**RASTI FLAMUR KEQA** - rast i dyshuar për konflikt të interesit në sferën publik-publik. Keqa i punësuar si drejtor në MTI (edhe pse i suspenduar, mirëpo mund të hiqet suspendimi në çdo kohë), dhe anëtar i bordit në KEK. Edhe pse ushtrimi i këtyre dy funksioneve nuk mund të konsiderohet konflikt i interesit në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, mirëpo me pranimin e pagesës për mbledhje të bordit si lloj meditje, është në kundërshtim me nenin 15 pika 2 të ligjit. AKK përmes vendimit për mbyllje të rastit për mungesë provash, pikërisht bazohet për mosshkelje të këtij neni, e që realisht është e kundërta, sepse neni 15 pika 2 thotë “Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme,” e zyrtari në fjalë në bazë të vendimit të AKK-së, pranon meditje për takimet e bordit. Pranimi i meditjes për takimet e bordit e bëjnë pikërisht në shkelje të ligjit zyrtarin në fjalë, dhe këtu AKK ka nxjerrë një vendim kundërligjor, duke e konstatuar gjendjen si në pajtim me ligjin.

**RASTI HAKI MAXHUNI**- Dy pozita publike, drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm, në MTI dhe anëtar i bordit në ujësjellsin e Mitrovicës. Pozitat e zyrtarit në

bazë të vendimit të AKK-së konsiderohen si pozita jo vendimmarrëse, e realisht të dy pozitat janë vendimmarrëse, sepse drejtori e udhëheq dhe merr vendime për departamentin që udhëheq, gjithashtu organ vendimmarrës në një kompani publike është bordi i drejtorëve. Referenca ligjore e AKK-së, është neni 15 pika 2 ku thotë “Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme”, ketu nuk sqarohet sikur ne rastin Keqa, se zyrtari a merr meditje për mbledhje të bordit në kompaninë e ujësjellsit Mitrovica apo jo, për arsye se pagesa për anëtarë të bordit është pagesë që bëhet me meditje e jo më pagë fikse.

**RASTI BAJRAM MUSTAFA**- rasti mbyllet për mungesë provash për konflikt të interesit ndërmjet pozitave të kordinatorit në Trepça, dhe anëtar i bordit në ndërmarrjen publike Iber Lepenci. Në vendimin e AKK-së, vetëm konstatohet se mbyllet rasti për mungesë provash, dhe fare nuk referohet se në bazë të ciles dispozitë ligjore të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit mbështetet vendimi. Një vendim pa u referuar fare në Ligjin për Konflikt të Interesit, edhe pse pozitat e zyrtarit janë funksione të larta dhe lejojnë hapësirë për dyshime. Të dy pozitat janë pozita të sferës publike, ndërmarrje publike.

**RASTI QEMAIL MUSTAFA** - me vendim të AKK-së konstatohet gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, ku Mustafa ushtron funksionin e kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe njëkohësisht njëri ndër pronarët e kompanisë private “Frutta Viva”. Sipas vendimit të AKK-së, shkresa e parë paralajmëruese është bërë me datën 15.07.2011, ku zyrtari është bindur për situatën e konfliktit të interesit, mirëpo edhe 4 muaj pas paralajmërimit të agjencisë nuk e ka shmangur situatën e konfliktit të interesit, pas kësaj kohe agjencia prapë i dërgon një shkresë tjetër paralajmëruese (shkresa e dytë), ku kërkon nga zyrtari të shmangë konfliktin brenda afatit të dhënë ligjor. Këtu së pari nuk dihet fare se sa afat i ka dhënë agjenica zyrtarit për ta shmangur konfliktin e interesit, edhe pse në bazë të vendimit janë 4 muaj në mes të shkresave dhe zyrtari nuk e ka shmangur konfliktin e interesit. E dyta në vendim të agjencisë thuhet brenda

afatit ligjor, mirëpo ligji askund nuk përmend afatin se për sa kohë duhet zyrtari të bëjë shmangien e konfliktit të interesit, por kjo ka mbetur në dorë të agjencisë që të vendos. Pikërisht këtu mund të ndodhë keqpërdorimi i afateve të dhëna, sepse agjencia mund të jap afate të ndryshme varësisht j zyrtarit. Gjithashtu mos publikimi, ose mungesa e afatit të dhënë për shmangie të konfliktit të interesit në vendimet e agjencisë krijon hapësirë për të dyshuar keqpërdorim të afateve. Hipotetikusht AKK-ja mund të lejojë edhe shkeljen e afateve nga zyrtarët nëse nuk e respektojnë afatin e dhënë.

Nga logjika e argumenteve që rrjedhin pas analizës dhe komenteve të shtruara më lartë, dalin në pah dy lloj problesh:

→ Së pari, AKK-ja, çështjen e konfliktit të interesit e konsideron vetëm si proces që ndodhë në rrethana aktuale, pra nuk e merr për bazë asnjëherë konfliktin e interesit si mundësi për t'u shfaqur, gjë që reflektohet në të gjitha vendimet e saj pa përjashtim; dhe

→ Së dyti, mangësitë ligjore pothuajse e pamundësojnë një parandalim të plotë të konfliktit të interesit duke e bërë sistemin ekzistues që rregullon konfliktin e interesit, një sistem prapaveprues apo veprues vetëm pas efekteve të konfliktit të interesit e që bie ndesh me logjikën globale që është e spikatur edhe në vetë emërtimin e ligjit, pra parandalimin e rrethanave që ndikojnë në shfaqjen e tij;

Kësisoj, ngjashëm si te deklarimi i pasurisë, ashtu edhe tek parandalimi i konfliktit të interesit, AKK-ja shprehë tipare administrative më shumë sesa analitike në vendimet e saj kur konstaton nëse ka apo jo konflikt të interesit në një rast të caktuar.

Kjo qasje, mund të duket e suksesshme vetëm në kuptim të numrave të rasteve të trajtuara por nuk jep asnjë indikacion mbi efektet reale të parandalimit të dukurisë në fjalë.

Se çfarë do të duhej të ndërmerrej në mënyrë që sistemi i parandalimit të konfliktit të interesit të jetësohet në kuptim të plotë të fjalës, dhe të marrë tipare serioze që ulin ndikimin e paligjshëm të zyrtarëve gjatë ushtrimit të funksionit publik në raport me interesat e tyre private, çfarëdo natyre qofshin ato, i mbetet për të vendosur një spektri më të gjerë akterësh. Megjithatë, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se edhe ky sistem ka nevojë imediate për rishikim, dhe atë në dy rrafshje:

→ Rishikim i plotë i bazës ligjore; si dhe

→ Ridefinim i metodologjisë që duhet të zë vend me rastin e konstatimit nga ana e AKK-së të gjendjes së konfliktit të interesit, duke anashkaluar qasjen ortodokse dhe duke sjellë një qasje pro aktive analitike, efektet e së cilës do të mund të shërbenin jo vetëm në parandalim dhe ndëshkim të shkelësve të ligjit, por edhe në vetë natyrën edukative të sistemit;

Lidhur me ndryshimet që në kontekstin tonë të të kuptuarit duhet të zënë vend, si në raport me procesin e deklarimit të pasurisë ashtu edhe në raport me konfliktin e interesit, më poshtë kemi përfshirë disa rekomandime themelore që do të duhej të shërbenin si nxitëse prej ku do të duhej të zinte vend debati i mirëfilltë institucional në mënyrë që të kemi një sistem efikas kundër korrupsionit dhe në mënyrë që mekanizmat që implementojnë këtë sistem, siç është AKK-ja, të mund të ushtrorj mandatin e mirëfilltë institucional dhe etik për të cilin kanë pritur dhe ende presin ta shohin qytetarët e Republikës së Kosovës.



# PËRFUNDIME ANALITIKE DHE REKOMANDIMET PËRCJELLËSE

Në rrjedhën logjike të argumenteve të shtruarra në këtë analizë politikash, në të cilën janë specifikuar disa fusha dhe aspekte problematike në procesin e deklaramit të pasurisë dhe atë të konfliktit të interesit, rekomandimet e Çohu!-të lidhur me këtë agjendë janë dhënë në vijim:

01

Megjithëse është argumentuar dhe avokuar edhe më herët, nevoja ngelet e njëjtë që legjislacioni aktual duhet të rishqyrtohet dhe të harmonizohen ligjet themelore kundër korrupsionit me ligjet tjera relevante dhe veçanërisht me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;

02

Është e nevojës imediate që të shqyrtohet dhe amendamentohet Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, në kuptim të asaj që të adresohen shumë qartë aspektet lidhur me mandatin e saj, posaçërisht rreth kontrollit të plotë të pasurisë dhe paralelisht me këtë mandat të specifikohet edhe shkalla e kompetencave dhe instrumentet përkatëse të nevojshme për realizimin e këtij kontrolli; Në linje me këtë, është e nevojshme që të reflektohet me ligj edhe natyra e dokumenteve të AKK-së në mënyrë që të njëjtat të marrin tipare të plota juridike dhe të shërbejnë si bazë mbi të cilat mund të iniciohet kërkimi i llogaridhënies dhe penalizimi në çdo rast ku ka paqartësi lidhur me kategoritë e problemeve të tilla çfarë edhe janë prezantuar në këtë hulumtim;

**03**

Shqyrtimet ligjore në të ardhmen duhet të përfshijnë dhe t'i kushtojnë një vëmendje të theksuar edhe aspektit socio-politik dhe socio-kulturor në mënyrë që lufta kundër korrupsionit të reflektojë një pikëpamje më të zgjeruar të korrupsionit politik, përfshirë edhe pikat e mundshme ku ai është prezent, format e manifestimit dhe shtrirjen e tij horizontale dhe vertikale në institucione;

**04**

Agjencia Kundër Korrupsionit, duhet të fuqizohet me staf shtesë dhe profesional posaçërisht në aspektin e hulumtimit dhe analizave aritmetike mbi relacionin e të hyrave dhe pasurive të poseduara nga zyrtarët e lartë publikë si dhe me staf profesional administrativ në mënyrë që gabimet njerëzore që karakterizojnë bartjen e të dhënave nga formularët në regjistra të evitohen përfundimisht;

**05**

Agjencia Kundër Korrupsionit, duhet të ketë një qasje më pro aktive në evitimin e rasteve të 'deklarimit të rrejtshëm' të pasurisë përmes kontaktimit të zyrtarëve dhe ofrimit të mundësisë për shpjegime dhe arsyetime të nevojshme, në mënyrë që t'i shërbejë procesit të deklarimit të pasurisë dhe të evitohet qasjen e deritanishme të procedimit të rasteve drejtpërdrejt në gjyq, duke rritur numrin e lëndëve si indikator të punës së saj;

**06**

Mungesa e standardeve për konstatim të vlerës së deklaruar paraqet po ashtu një problem pasi që AKK-ja nuk ka në dispozicion asnjë mekanizëm për të vlerësuar përmbajtjen apo vlerën reale të pasurisë së deklaruar nga ana e zyrtarëve të lartë publikë. Rrjedhimisht, kjo i pamundëson AKK-së dhe çdo pale tjetër që të bëjë analiza që ka për bazë llogaritjen aritmetike në mes të hyrave dhe pasurive të deklaruara, mbi bazën e së cilave do të mund të konstatonte përputhshmërinë në mes të standardit të jetës së zyrtarëve të caktuar duke i krahasuar me të hyrat vjetore. Në rishqyrtimin e ligjit, kjo çështje duhet të zë vend primar që të sjellë një format të ri institucional që rregullon një herë e mirë këtë aspekt;

**07**

Një aspekt problematik dhe që ka ndikuar në shkallën e ultë të dënimeve edhe në të kaluarën por edhe tani, lidhet me mos përpunimin e duhur të lëndëve nga ana e AKK-së, konkretisht në atë se çka ky mekanizëm ka konsideruar si deklaram i rrejtshëm i pasurisë dhe që komplikon nxjerrjen e vendimeve të prera dhe fuqiplota të gjykatave. Një fokus i veçantë brenda strukturës së AKK-së duhet të zë vend, në mënyrë që lëndët e përpunuara nga AKK-ja të jenë kuptimplota, të argumentuara dhe të shërbejnë si bazë juridike për procedim të mëtejshëm penal;

**08**

Mandati i AKK-së duhet të profilizohet në kuptim të kompetencave administrative apo hetuese në mënyrë që të dihet saktë roli i saj në procesin kundër korrupsionit, për shkak se praktika e deritanishme e të sjellurit herë si organ administrativ e herë si organ hetues dhe tendenca për të rritur kompetencat e saj përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit nuk ka sjellë asnjë rezultat;

**09**

Ligji për Konfliktin e Interesit duhet të rishikohet dhe të definohen qartë nocionet dhe konceptet se çka paraqet konflikti i interesit në tërësi dhe të sanksionohet i njëjti si vepër penale në harmoni me Kodin Penal të Kosovës;

**10**

Në kuadër të rishikimit, ligji duhet të definojë shkallën e shtrirjes në kuptim të niveleve të qeverisjes qendrore dhe asaj lokale, si dhe institucioneve të tjera të pavarura publike. Po ashtu, në këtë bazë, ligji duhet të definojë shkallën e përfshirjes së nivelit të zyrtarëve nëse është e nevojshme të zgjerohet e njëjta apo të ngushtohet e njëjta;

**11**

Në kuadër të rishikimit të Ligjit për konflikt të Interesit, duhet të ridefinohet momenti kur zyrtari është në konflikt të interesit jo vetëm si akt ekzistues por edhe si situatë për shkak se aktualisht, baza ligjore i referohet konfliktit të interesit si proces e jo si perspektivë e diçkaje se si mund të ndodhë dhe në çfarë rrethanash mund të shfaqet i njëjti;

**12**

Natyrë e legjislacjonit të ardhshëm mbi konfliktin e interesit duhet të jetë e bazuar në shkallën më të lartë në parandalim, pasuar nga dënimi dhe ndjekja penale. Megjithatë, efektet reale do të shiheshin nëse baza ligjore ndërtohet në atë frymë që parandalimi të jetë primar dhe dominues;

**13**

Në kuadër të rishikimit të Ligjit për Konflikt të Interesit, duhet të sqarohen në detaje procedurat dhe nocionet e “përfitimit të padrejtë” për shkak se dispozitat ligjore ekzistuese që kanë për referencë këtë aspekt, janë jashtëzakonisht të paqarta mbi atë së çka nënkupton përfitimi i padrejtë dhe rrjedhimisht mund të përbëjnë komplikim në rastet eventuale të shqyrtimeve gjyqësore;

**14**

Dispozita ligjore që fton për mbrojtje të personave që ofrojnë informata për rrëfyesit e rasteve të konfliktit të interesit, duhet të plotësohet edhe me dispozita ligjore që ofrojnë mbrojtje kuptimplotë edhe për zyrtarët që ekspozojnë rastet e konfliktit të interesit ngase zyrtarët potencial që dëshirojnë të ofrojnë të dhëna mbi rastet e konfliktit të interesit brenda institucionit ku punojnë, aktualisht nuk kanë asnjë lloj mbrojtje.

**15**

Sipas pikëpamjes holistike që ekziston në ligjin aktual, zyrtarët me rastin e marrjes së detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj janë të ftuar që të vetë rregullojnë çështjen e konfliktit të interesit por në ligj nuk ka asnjë specifikim të afatit kohor se deri në çfarë periudhe kohore pas marrjes së detyrës zyrtare, zyrtari duhet të ketë zgjidhur çështjen e konfliktit të interesit. Rrjedhimisht, një afat ligjor duhet të përcaktohet me ligjin e ri. Ngjashëm me këtë, duhet definuar edhe cilat janë ato masa që ligji aktual u referohet e të cilat zyrtari duhet t'i ndërmarrë për të shmanhur konfliktin e interesit;

**16**

Duhet të definohen në mënyrë precize afatet kohore në terma konkret. Nëse ligji specifikon obligimin e zyrtarit për të bartur të drejtat e udhëheqjes të ndërmarrjes private brenda një periudhe prej 30 ditësh, atëherë është e nevojshme që specifikimet e kësaj natyre të jenë precize, pra të konkretizohet nëse behët fjalë për 30 ditë kalendarike apo 30 ditë punë;


**17**

Duke iu referuar praktikave dhe legjislacioneve progresive mbi konfliktin e interesit, konsiderojmë se është e nevojshme të largohen disa adresime që lidhen me retroaktivitetin. P.sh. në Nenin 22, pika 2 që specifikon se: Inicimi i procedurës për konflikt të interesit në Agjenci nuk mund të fillojë nëqoftëse kanë kaluar dy (2) vite nga data e kryerjes së veprimit, përveç kur parashihet ndryshe me ligj. Konsiderojmë se kjo pike duhet të largohet përfundimisht, sepse lejon parashkrimin ose vjetërsimin e rasteve të konfliktit të interesit. Kjo nënkupton një amnisti për shkelësit e këtij ligji dhe situata kur qëllimisht zyrtarët kanë lejuar situata të konfliktit të interesit, dhe për këto raste është kuptuar pas dy viteve, ky rast nuk mund të iniciohet për shkak të parashkrimit;

**18**

Nëse merret për bazë shkalla e dënimeve dhe gjobave për shkelësit e ligjit për konflikt të interesit, konsiderojmë se kjo bazë është e papërfillshme në raport me përfitimet që një zyrtar mund t'i ketë nga ushtrimi i ndikimit të tij në vendimmarrje në raport me interesat private. Rrjedhimisht, në draftin e ri të ligjit, duhet të rritet ndjeshëm shkalla e gjobave dhe masave të tjera ndëshkuese në mënyrë që të nxisin një vetëdijesim më të madh për zyrtarët rreth natyrës së dënimeve që do të pasojnë në rast se lejojnë konfliktin e interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.





**Agjencia Kundër Korrupsionit,  
duhet të fuqizohet me staf shtesë  
dhe profesional posaçërisht  
në aspektin e hulumtimit dhe  
analizave aritmetike mbi relacionin  
e të hyrave dhe pasurive të  
poseduara nga zyrtarët e lartë  
publikë**



“Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (SCO) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.



